



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga Procesverbali i mbajtur më 20 nëntor 2019, në mbledhjen e XVIII-të (tetëmbëdhjetë), mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr.31 dhe filloi në orën 13;35.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Mehmet Gashi, Arlinda Kadriu, Avni Fetahu, Fatlume Jaha, Adelinë Stublla, Rafet Llapashtica, Floretë Zejnullahu dhe Fitim Haziri.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin; Abaz Llugaliu, Drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë – DPKGJ, Isuf Latifi, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, Zaim Thaqi, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, Mirsad Kamerolli, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik – DPZHE, dhe Driton Nuli përfaqësues i OSBE-së.

Rendi i ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe i njoftoj rreth pikave të paraqitura në këtë rend të ditës, shtoi, besoj që thirrjen materialin përkatës për këtë mbledhje e keni marrë të gjithë me kohë, andaj mund të vazhdojmë me punë.

Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës

1. Propozimi i Vendimit për vënie në diskutim publik Draft Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020 – 2022

z.Mirsad Kamerolli, drejtori i DPZHE, e paraqiti fjalën hyrëse ndër të tjera theksoi, Draft Strategjia e Zhvillimit Ekonomik për vitin 2020-2022 është dokumenti strategjik me peshë më të madhe në Komunën e Podujevës. Është dokument që e orienton Komunën drejt një zhvillimi të qëndrueshëm.

Me këtë dokument Komuna e Podujevës ofron vizion dhe mision, përcakton qëllim strategjik, objektiva të matshme dhe mjete për ta orientuar Podujevën drejt një Komune të zhvilluar. Podujeva sikurse edhe komunat tjera në nivel Kosove pas lufte është ballafaquar me një infrastrukturë të rrënuar, institucione shkollore të vjetruara, administratë të trashëguar, mungesë të shërbimeve adekuate shëndetësore dhe shumë probleme të tjera që kanë i kanë shumëfishuar problemet sociale të qytetarëve gjatë 20 viteve të fundit, pothuajse të gjitha investimet kapitale janë drejtuar drejtë ndërtimit të infrastrukturës rrugore, kanalizimit, ndërtimit dhe rindërtimit të shkollave dhe objekteve shëndetësore për një qytet funksional. Tani sfida kryesore mbetet zhvillimi i ulët i sektorit të prodhimit dhe kultivimi i produkteve bujqësore.

Me vlerë të shtuar sigurimi i cilësisë në arsim dhe mjedis shkollor, ofrimi i shërbimeve sociale cilësore dhe rritjen e numrit të shërbimeve nga institucionet të kujdesit primar shëndetësorë si dhe zhvillimin e kulturës dhe sportit. Kjo strategji ofron një pasqyrim real të gjendjes së sektorëve rritës dhe mbështetës të ekonomisë lokale. Thekson nevojën paraqet sfidën mundësit për përmirësimin, përcakton rrugët për një komunë të suksesshme me mundësi të barabarta për të gjithë. Hartimi i Strategjia e Zhvillimit Ekonomik lokal ka kërkuar një qasje të gjithëpërfshirëse që përmbajnë akter nga institucione dhe fusha të ndryshme për shkak të rëndësisë ekonomike, gjeografike dhe sociale në Komunën e Podujevës, për këtë arsye ne kemi parashikuar zbatimin e një metodologjie të punës e cila siguron pjesëmarrjen e plotë të akterve nga fushat kryesore që ndikon në zhvillimin e qëndrueshëm. Për hartimin e dokumentit strategjik dhe për një analizë janë mbledhur informata primare dhe sekondare, janë shfrytëzuar informata edhe nga niveli qendrorë si: Agjencioni Zhvillimor i Bujqësisë, Agjencioni i Zhvillimit të Bizneseve, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Trusti Pensional dhe Administrata Tatimore e Kosovës. Për më shumë janë angazhuar takime, intervista dhe fokus grupe me përfaqësues të qytetarëve po ashtu duke filluar nga bizneset, fermerët shoqatat bujqësore, nxënësit, arsimitarët, ekzekutivi i komunës dhe akterët tjerë.

Ky dokument strategjikë bazohet në tri qëllime kyçe strategjike që i mundëson Komunës tonë të ketë një përparim në zhvillimin ekonomik lokal në tri vitet e ardhshme. Zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm të qëndrueshëm të sektorit privat të nxitjes dhe zhvillimi të hovshëm dhe të qëndrueshëm të ekonomisë me qëllim të gjenerimit dhe punësimit. Arritja e këtij qëllimi strategjik mundësohet përmes rritjes së investimeve publike infrastrukturore që e përmirësojnë ambientin e të bërit biznes me theks të veçantë në krijimin dhe funksionalizimin e zonës ekonomike, nxitjes së inovacionit përmes partneritetit publiko-privat, stimulimin dhe zhvillimin ekonomik përmes investimeve të huaja direkte, zvogëlimin e deficitit tregtar përmes rritjes së shumë prodhimit të prodhimeve vendore, rritjen e prodhimit lokal. Nxitjen e ndërmarrësve të rinj përmes hapjes së bizneseve të reja dhe startapp-ave të qëndrueshëm. Qëllimi tjetër strategjik paraqet zhvillimin e qëndrueshëm social përmes fuqizimit të qytetarëve për të realizuar potencialet e tyre të plotë përmes sigurimit të mundësive të barabarta në arsim, shëndetësi, jetë sociale cilësore. Arritja e këtij qëllimi strategjik mundësohet përmes përmirësimit të kushteve të jetesës, ndërtimi i një sistemi gjithëpërfshirës dhe llogaridhënës në arsim, me menaxhim cilësor, me mësimdhënës të përgatitur, me kushte që sigurojnë arsim dhe mjedis cilësor për nxënësit, krijimin e një infrastrukture të fort dhe krijimin e infrastrukurës në shërbime shëndetësore cilësore që ju mundëson qytetarëve të gëzojnë shëndet të mirë fizik, krijimin e një jete të dinjitetëshme për të gjithë qytetarët me theks të veçantë për të moshuarit dhe personat me nevoja të veçanta, nëpërmjet investimeve për rinin konkretisht në fushën e kulturës dhe sportit. Këto dy qëllime strategjike për Komunën tonë nuk mund të arrihen pa një menaxhim më efikas të Komunës përmes përmirësimit të vazhdueshëm të menaxhimit njerëzor dhe financiar bazuar në praktikën e mira ndërkombëtare dhe vetëqeverisjes lokale. Prandaj, qëllimi i këtij projekti strategjik mbetet menaxhimi i qëndrueshëm. Arritja e këtij qëllimi strategjik mundësohet përmes optimizimit dhe zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së Komunës tonë, bashkërendimin e politikave, qëllimet operative dhe fondet e komunës me prioritetet e qytetarëve, fermerëve, sektorit privat, rinis dhe shoqërisë civile, ofrimin e shërbimeve të përgjithshme të qëndrueshme, sigurim të qëndrueshëm financiar afatgjatë të Komunës. Ky dokument ofron zgjidhje praktike për shumë probleme aktual e përmirëson pozicionin konkurrues të Podujevës në raport me komunat tjera, komfor këtij pozicioni konkurrues dhe kufizimeve buxhetore janë përcaktuar edhe masat, projektet dhe hapat kyç për periudhën 2020-2022. Prandaj, kërkohet nga ju që ta rekomandoni për seancën e radhës që kjo draft Strategji të shkojë për diskutim publik.

Sa për sqarim, drafti përfundimtar i Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik 2020-2022 do të jetë i shtypur në tri gjuhë, në gjuhën Shqipe, Gjermane dhe Angleze.

Ka mundësi me u bë edhe më e mirë dhe po shpresojmë në një bashkëpunim të sigurt të bëjmë më të mirën e mundshme për hir të qytetarëve të Komunës së Podujevës dhe ta arrijmë ta kompletojmë këtë dokument.

z.Avni Fetahu, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrahë këtë strategji që e njëjta të vëhet në diskutim publik, sigurisht që gjatë diskutimit publik do ti japim sugjerimet tona. Unë kam dy pyetje, njëra është sa ka kushte përgatitja e kësaj strategjie nga kompania e cila ka qenë e kontraktuar dhe a ka pas përpjekje që të krijohen grupe punuese në të ardhmen që vet me kapacitete komunale të krijohen strategji të tilla që janë në interes të Komunës së Podujevës.

z.Fitim Haziri, theksoi, ne si Grup i Lëvizjen Vetëvendosje jemi pro që kjo pik të rekomandohet për seancën e radhës por e kam një pyetje edhe unë meqenëse e dëgjova drejtorin që tha që ky dokument e ka një rëndësi të veçantë për zhvillimin e Komunës tonë, prandaj deshta ta di se prej vitit 2018 Komunës i mungon një dokument i tillë që do të thotë që dy vite Komunës së Podujevës i mungon një dokument i tillë dhe pajtohem plotësisht me atë që tha Avnia si dokument strategjik, strategjinë e ndërton ai që është në qeverisje dhe e bënë planin e vet në bazë të prioriteteve që i ka, pse atëherë ne po u dashka që një planë strategjik të ia japim një kompanie që ta dizajnon planet strategjike duke i përfshirë sektorët e ndryshëm dhe mos me qenë i gatshëm ai që e udhëheq Komunën të bërë një plan strategjik vet.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, sa i përket pyetjeve të parafolëseve edhe unë i kisha po të njëjtat.

Ka qenë një komitet i formuar në vitin 2014 nëse nuk gaboje komitetit i Kuvendit për Zhvillimin Ekonomik ku janë përzgjedh ekspert e të intervistuar nga ana e një Komisioni i Kuvendit Komunal, Komitet i cili në bazë të ligjit mund të mbaj maksimum gjashtë takime brenda vitit, me pagës të ngjashme me KPF, që jep rekomandime për Kuvend. Nuk jam në dijeni sa ka dhënë kontribut kjo kompani që e ka përgatit këtë Strategji për Zhvillim, nuk e di a është kontaktuar nga ndokush së paku si trup zyrtare e Komunës e përzgjedhur në bashkëpunim me Ekzekutivin edhe me anëtarët e Kuvendit sepse kanë qenë edhe dy anëtar të Kuvendit, ndoshta drejtori na kish jap ndonjë përgjigjeje para miratimit. Unë kisha deshtë që dokumenti të miratohet në Kuvend pasi të përfundon diskutimi publik, që kompania private të shoh orientimin e zhvillimeve të biznesit dhe ne të miratojmë strategjinë me tendencë të dikujt nga jashtë këtë nuk kisha dashtë ta bëjmë, në njëfarë forme një orientim strategjik sepse ne nuk kemi as plan të zhvillimit urban as shumë gjëra të tjera që ta dimë se kah do të jetë zhvillimi i Podujevës sepse qyteti duhet të zhvillohet, bizneset, zonat industriale, objektet me shumicë e nuk po flasim për artizanatet, prandaj le të del në diskutim publik e të shohim pastaj.

z.Mirsad Kamerolli, drejtori i DPZHE, sqarim, dua ti përgjigjem këshilltarit z.Avni Fetahu, Komuna kishte qenë mirë ti ketë kapacitetet dhe mundësit edhe në profile të caktuara për me qenë e mundur ti bëjë këto dokumente strategjike, megjithatë këshilltari në fjalë por edhe të tjerët besoj i dinë mundësit sa janë por shpresojmë që në të ardhmen do ti forcojmë kapacitetet tona për secilin dokument dhe dokumentet tjera strategjike që munden me qenë në të ardhmen të kemi kapacitete të brendshme dhe ti krijojmë këto dokumente me rëndësi të veçantë. Sa i përket shumës sa ka kushtuar, nuk jam interesuar unë personalisht të dijë këtë, por kjo çështje ka qenë publike, kanë marrë pjesë nëse nuk gaboje shtat kompani, mirëpo që ne kemi pas të planifikuara 20.000,00€ ndërsa kanë tepruar afër 6,000.00€ por nuk e di saktë apo duhet ta pyesim zyrën e prokurimit, mirëpo drejtori i DBF tani ma bënë me dije se shuma sa ka kushtuar për këtë dokument është 17,900.00€ euro.

Këshilltari z.Fitim Haziri pyeti për periudhën kohore që ka mbet pa këtë strategji komuna, në fakt ne si Drejtori në fund të vitit 2018 dhe në fillim të vitit 2019 është dashtë të presim deri sa janë zhvilluar procedurat, pastaj deri është zgjedh kompania dhe janë katër muaj që është duke u përgatitur në mënyrë

të vazhdueshme ky dokument, kështu që afati kohor për përgatitjen e kësaj strategjie është gati një vit. Sa i përket pyetjes së z.Rafet Llapashtica, ne e kemi pas si projekt të domosdoshëm të zhvillimit ekonomik, ngritjen e zonës ekonomike e që në Kuvend është marrë vendimin se ku duhet të vendoset ajo zone ekonomike, por për shkak të problemeve të cilat sigurisht jeni në dijëni edhe ju kjo çështje ka mbet pezull por që shpresojmë që zhvillimi do të jetë i orientuar kah zona ekonomike për periudhën kohore tri vjeçare. Secila pjesë e Komunës së Podujevës që zhvillohet është shumë e rëndësishme, nuk ka mundësi dhe nuk do ti japim shansin askujt që do të punoj kundër interesit të Komunës dhe ti jap orientim zhvillimor vetëm një pjesë të caktuar të vendit dhe pjesës tjetër jo.

z.Rafet Llapashtica, pyetje, a është bërë pagesa e anëtarëve të Komitetit për Zhvillim Ekonomik.

z.Mirsad Kamerolli, drejtori i DPZHE, përgjigje, po, kur e kam marrë detyrën i kam takuar i kam konsultuar, i kemi pasur katër takime, fatkeqësisht kërkesa e tyre ka qenë që ata të jenë aktiv në mënyrë të vazhdueshme dhe të paguhen, por mundësit e krijuara nuk e parashohin të paguhen, kështu që angazhimi i tyre direkt me kohë të plotë në këto dokumente ka mbet në vullnetin e tyre, përndryshe nuk po besoj që kanë pasur bashkëpunim më të haptë me dikën prej Ekzekutivit se sa me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik gjatë kësaj periudhe qe një vit e gjysmë që jam këtu.

z.Isuf Latifi, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, theksoi, sa i përket kësaj strategjie nëse ka ndonjë bazë ligjore që të aprovohet brenda vitit aktual do të ishte shumë mirë për shkak se do ta zëmë afatin kohorë për pagesë në tërësi, kështu që është mirë të shikohet mundësia ligjore që pas afatit që merr kohë për diskutim publik të shqyrtohet mundësia maksimale që kjo të miratohet gjatë këtij viti, nga fundi muajit dhjetor në mënyrë që mos të prolongohet pagesa dhe të kaloj në vitin 2020.

z.Mehmet Gashi, theksoi, sqarim rreth komitetit që u cek, komitetet konsultative janë dy nëse nuk gabohem Komiteti për Zhvillim Ekonomik dhe Komiteti për Shërbime Publike, në bazë të ligjit ato komitete kanë mundësi që për çdo material që sjellët në Kuvend, varësisht fushave përkatëse, kanë mundësi të japin ndonjë sugjerim, jo diçka tjetër, vendim etj, kurse pagesa e tyre ka qenë 50€ por jo më shumë se gjashtë mbledhje në vit, nuk e di a kanë pasë buxhet apo jo por e di që nuk mund të paguhen më shumë se kaq. Tek pyetja e Drejtorit të DBF se a ka mundësi të miratohet ky dokument para datës 26 dhjetor, dihet se Kuvendi mundet me mbajt mbledhje por më shumë se 12 nuk paguhet, mirëpo nuk është problem me mbajt edhe një mbledhje në fund të dhjetorit, dhe Kryesuesi të na thirrë thirr edhe në ndonjë darkë diku për fundvit sepse pagesë për këshilltarët nuk ka më shumë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, kjo pik nuk mund të hyj si pik e rendit të ditës në seancë të rregullt para datës 26 dhjetor sepse nuk mund të zihen afatet ligjore për seancë të rregullt, ndërsa për seancë të jashtëzakonshme duhet të gjendet arsyeshmëria, por shpresojmë të gjejmë mundësin dhe do të bëjmë të pamundurën që kjo pik të miratohet.

pas votimit, njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, me rekomandim që dokumenti i Draft Strategjisë për Zhvillimin Ekonomik Lokal 2020 – 2022 në Komunën e Podujevës, të vihet në diskutim / debat publik, dhe atë, diskutimi publik të zgjatë 30 ditë, përkatësisht nga data 22 nëntor 2019 deri më 22 dhjetor 2019, ndërsa debati publik me qytetarë të mbahet më 02 dhjetor 2019 duke filluar në ora 11;00 në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

2. Propozimi i Rregullore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2020

- *Raporti i Ministrisë së Financave – Departamenti i Tatimit në Pronë, mbi vlerësimin e përgjithshëm për objektet rezidenciale në Komunën e Podujevës, (për njoftim)*

z.Isuf Latifi, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, në rend të ditës është Rregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme, në Ligjin për tatimin në pronë nr.06/L-005 thuhet se kompetencat që kanë qenë në nivelin lokal barten në nivelin qendror, andaj sipas këtij ligji Kuvendit Komunal i mbeten vetëm caktimi i normave tatimore. Bazuar në nenin 17 që janë procedurat e vlerësimit dhe neni 8 vlerësimi i pronave të paluajtshme, të dy këto nene e obligojnë Ministrinë e Financave - Departamentin e Tatimit që t'i udhëheq procedurat e vlerësimit dhe të bëjë vlerësimin e pronave të paluajtshme dhe t'i raportoj komunave për ato procedura dhe vlerësime siç është rasti për raportin që e kemi për pronat rezidenciale. Ministria e Financave nuk ka arritë që të bëjë vlerësimin e pronave komerciale por në momentin e fundit është dorëzuar raporti tek ne që Kuvendi Komunal të merret edhe me këtë pjesë të vlerësimit për vitin 2020 për shkak të pamundësisë së vlerësimit sipas ligjit. Në ligj është norma e caktuar që Kuvendi i Komunës duhet të caktoj e që ne i kemi propozuar me norma thuajse minimale, ku kemi filluar me 15% tek normat komerciale dhe 20% ato industriale, por ligji e mundëson prej 15 deri në 1 euro m² për pronat rezidenciale, për pronat pyjore 0.15% deri në 30%, për pronat bujqësore prej 15% deri 20% dhe për parcelat dhe pronat industriale prej 15 deri 80 cent për m². Neve në këtë rast na ka mbetur të caktojmë normat tatimore dhe vlerësimin për m² për pronat komerciale dhe ato industriale që edhe kjo vitin e ardhshëm të mbetet obligim i Ministrisë që të udhëheq procedurat dhe të bëjë vlerësimin konform Ligjit për tatimin në pronë për vitin 2020, ndërsa mbetet që në vitin 2021 të përcaktohet, atëherë Kuvendi Komunal nuk do të nxjerr më rregullore pasi që thuhet se do të nxirren akte nënligjore, por thotë që vendos norma tatimore, prandaj do të mbetet me një vendim të Kuvendit të Komunës natyrisht me propozim të Kryetarit të Komunës të caktohen edhe normat tatimore.

Duke e parë gjendjen ku jetojmë kemi përcaktuar norma minimale të cilat sigurisht edhe Kuvendi ka mundësi të propozoj norma tjera edhe Ekzekutivi por për situatën aktuale ekonomike – sociale, kemi vlerësuar që edhe në këtë rregullore të jetë norma minimale 0,15% dhe 0,20% tek pronat industriale dhe komerciale. Është një fat i mirë që vitin e kaluar në Rregulloren kemi thënë që do të hyj tatimi në tokë por realisht nuk ka filluar të aplikohet në vitin 2019 për tokat bujqësore. Tatimi ka filluar të aplikohet në pronat pyjore edhe në pronat rezidenciale për parcela dhe oborre, në place komerciale dhe industriale, ndërsa për prona bujqësore në vitin 2019 nuk ka pasur tatim dhe sipas të gjitha gjasave nuk do të ketë as në vitin 2020, këtu duhet të bëhet një koordinim dhe një komision i përbashkët me Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, e që sipas të gjitha gjasave tatimi në prona bujqësore është prolonguar që mos të jetë as në vitin 2020.

Pas votimit, njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim sipas materialit të dërguar.

3. Ngritja e Grupit punues për hartimin dhe përgatitjen e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës, për vitin 2020.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, ne si Komitet për Politikë dhe Financa është mirë ta gjejmë një formulë që ta ngrisim një grup punues në Kuvend për hartimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2020, i lusim edhe drejtorët e Drejtorive që të sjellin pikat që ata planifikojnë t'i dërgojnë në Kuvend gjatë vitit 2020, andaj urdhëroni nëse ndokush ka ndonjë propozim rreth përbërjes së grupit punues.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, në grupin punues është mirë të jenë shefat e Grupeve të subjekteve politike, Ju si Kryesues i Kuvendit. E them këtë ngase asnjë anëtar i grupit politik nuk ka çka të shtoj më shumë se sa shefi i Grupit të tij, pra nëse ndonjë këshilltarë ka ndonjë propozim, të njëjtin e potencon te shefi i Grupit të tij i cili pastaj e paraqet në grupin punues.

z.Avni Fetahu, theksoi, meqenëse të gjithë e kanë mundësin nëse kanë ndonjë pikë që ta trajtojnë edhe në Kuvend, ne e bisedojmë edhe brenda Grupit se kush do të na përfaqësoj. E rëndësishme është ta kemi të gatshëm planin me kohë dhe mbi të gjitha të realizohet ajo çfarë kemi në plan sepse të kënaqur nuk jemi asnjë me prezantimin e punëve, raporteve dhe pikave tjera që i kemi miratuar vetë ne.

Thjesht, të përgatitim diçka që realizohet dhe ta prezantojmë para qytetarëve dhe që Ekzekutivi të ndihet mirë me atë plan.

z.Fitim Haziri, theksoi, e diskutojmë në mbledhje të Kuvendit edhe pse qëllimi jonë është që të jemi sa më shumë përfaqësues në Grup punues, ideja është që me pasë më shumë ide dhe propozime të ndryshme.

Pas votimit, njëzëri i rekomandohet Kuvendit për ngritjen e Grupit Punues për përgatitjen dhe hartimin e propozim Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2020, me sugjerim që gjatë mbledhjes së Kuvendit të caktohet formula, përkatësisht numri i pjesëmarrësve në Grupin Punues.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0089443/19

Podujevë,

20 nëntor 2019

Kryesuesi i Komitetit

Fatmir Gashi